

LIGJ
Nr. 15/2015

**PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E NEGOCIATAVE DHE ANËTARËSIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN**
(Ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në procesin e negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 2

Objekti

(Ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për rolin e Kuvendit në procesin e negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 3

Fusha e veprimit të ligjit

(Shtuar shkronjat “b/1”, “b/2” dhe “b/3” me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Fusha e veprimit të këtij ligji ka të bëjë me:

- a) rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrit dhe/ose kryenegociatorit përgjegjës për negociatat me Bashkimin Europian, institucioneve të pavarura ose të krijuara me ligj, në kuadër të negociatave me Bashkimin Europian;
- b) monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe të politikave në lidhje me procesin e negociatave dhe anëtarësimit, si dhe të asistencës financiare të ofruar nga Bashkimi Europian;
- c) monitorimin e procesit të negociatave;
- ç) procedurat për miratimin e akteve ligjore që përafrojnë legjislacionin shqiptar me *acquis* të Bashkimit Europian dhe akteve ligjore për plotësimin e kushteve dhe kritereve për anëtarësim;

d) informimin dhe komunikimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për procesin e negociatave dhe efektet e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 4

Përkufizime

(Ndryshuar shkronja “ë”, shtuar shkronja “gj” me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar shkronja “gj”, shtuar shkronjat “b”, “i”, “j”, “k”, “l”, “ll” dhe “m” me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Çështjet europiane” janë çështjet që dalin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

b) “Dokumente strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale” janë akte të organit publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ku shprehet vullneti dhe parashikimet për zhvillimin dhe realizimin e një politike të caktuar publike në fushat e ekonomisë, zhvillimit social, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, dhe marrëdhënieve me jashtë, të cilat mund të përcaktojnë shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore në një periudhë të caktuar kohore, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në to.

c) “Fondet e Bashkimit Europian” janë fondet që akordohen nga Bashkimi Europian për mbështetjen e vendit tonë në plotësimin e kriterëve dhe kushteve për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

ç) “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që ka interesa të përbashkët në fushën e integritetit europian, ose subjekte të tjera të interesuara për çështjet e integritetit europian.

d) “Institucionet e Bashkimit Europian” janë institucionet vendimmarrëse të Bashkimit Europian, si përcaktohen në të drejtën e Bashkimit Europian.

dh) “Kuatrë rregullator i negociatave /bisedimeve për anëtarësim” është kuadrë që përcakton parimet dhe udhëzimet për negociatat/bisedimet për anëtarësim, i përgatitur nga Komisioni Europian, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe i miratuar nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

e) “Projektakt” është projekti i një ligji, dokumenti strategjik, si dhe projekte të akteve normative, sipas fushës përkatëse të kompetencave, që kanë të bëjnë me çështje të integritetit europian.

ë) “Legjislacioni i Bashkimit Europian” është korpusi i normave detyruese dhe rekomanduese në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

f) “Plani kombëtar për integrimin europian, është programi kombëtar i miratuar nga Këshilli i Ministrave, që shërben për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit.

g) “Ministri përgjegjës” është ministri që përgjigjet për çështjet e integritetit europian.

gj) “Pozicion negociues” është pozicioni që do të prezantojë Republika e Shqipërisë për kapituj ose grup-kapituj të caktuar.

h) “Grup-kapitull” është një grupim kapitujsh bazuar në metodologjinë e rishikuar për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Europian, miratuar nga Bashkimi Europian në vitin 2020, sipas ndarjes në 6 grup-kapituj tematikë.

i) “Qëndrimi i Përbashkët i BE-së” është qëndrimi dhe objektivat e unifikuar të përcaktuar nga Shtetet Anëtare të BE-së për procesin e aderimit në Bashkimin Europian.

j) “Piketë hapëse, të ndërmjetme dhe përmbyllëse” janë kushte dhe objektiva specifike të vendosur nga Bashkimi Europian që një vend kandidat duhet të përmbushë për të arritur përparim gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit në BE, veçanërisht për hapjen dhe mbylljen e përkohshme të kapitujve negociues.

k) “Plani i përafrimit” është lista e akteve ligjore dhe rregullatore dhe/ose e masave shoqëruese të tjera që hartohen, miratohen dhe zbatohen për të përafruar legjislacionin kombëtar me *acquis* të BE-së në një periudhë të caktuar kohore dhe/ose për të përmbushur piketat.

l) “Procedura e përshpejtuar” për miratimin e ligjeve, që synojnë përafrimin me *acquis* të Bashkimit European, është një proces legjislativ i posaçëm, i cili lejon shqyrtimin dhe miratimin më të shpejtë të projektligjeve, që lidhen me detyrimet e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin European.

ll) “Procesi i negociatave dhe anëtarësimit” në Bashkimin European është një proces politik, juridik dhe institucional përmes të cilit një shtet kandidat harmonizon dhe përshtat legjislacionin, institucionet dhe politikat e tij me *acquis*, me qëllim përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe kushteve të tjera të vendosura nga BE-ja.

m) “Procesi i anëtarësimit” në Bashkimin European është procedura formale me anë të së cilës një shtet kandidat zhvillon negociatat me BE-në, hap dhe mbyll kapitujt e *acquis*, përmbush kriteret e përcaktuara dhe, pas përfundimit të tyre me sukses, nënshkruan dhe ratifikon Traktatin e Anëtarësimit që i jep statusin e shtetit anëtar.

Neni 5

Parimet dhe objektivat e përgjithshëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Procesi i negociatave dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European bazohet në parimet dhe objektivat e mëposhtëm:

- a) promovimi dhe mbrojtja e interesave strategjike kombëtare të Shqipërisë;
- b) përmbushja e kriterëve politike, ekonomike, ligjore dhe institucionale të kërkuara për anëtarësimin në BE;
- c) respektimi i parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të ligjshmërisë, të subsidiaritetit, të proporcionalitetit, të bashkëpunimit reciprok, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë së tregut.

KREU II

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Neni 6

Këshilli Kombëtar i Integrimit European

(Ndryshuar pika 3 dhe 4 me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; zëvendësuar togfjalësh në pikën 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Këshilli Kombëtar i Integrimit European është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për për anëtarësimin në Bashkimin European, që ngrihet pranë Kuvendit, i cili nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e anëtarësimit.

2. Këshilli Kombëtar i Integrimit European bashkëdrejtohet nga bashkëkryetari dhe bashkënenkryetari i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit.

3. Këshilli Kombëtar i Integrimit European përbëhet nga:

- a) kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare;
- b) përfaqësues të grupeve parlamentare të Kuvendit;
- c) kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin;
- ç) Avokati i Popullit;
- d) ministri përgjegjës për integrimin dhe ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European;
- dh) përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit;

e) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
ë) përfaqësues nga kabineti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
f) Prokurori i Përgjithshëm;
g) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
gj) Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

h) përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile të përfshira në çështjet e integritetit europian, të cilat i përgjigjen thirrjes për aplikim dhe ftohen për çdo grup-kapitujsh.

4. Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian marrin pjesë me statusin e të ftuarit sipas tematikës së takimit:

a) titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, të cilët raportojnë dhe informojnë Kuvendin dhe që nuk përfshihen në pikën 3 të nenit 6 të ligjit;

b) përfaqësues nga organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë, sindikatat, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim, në bazë të fushës së përgjegjësisë;

c) përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë publik;

ç) përfaqësues nga media, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim;

d) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.

5. Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian, sipas tematikës së takimit, fton të marrin pjesë edhe ministrat përgjegjës dhe/ose institucionet e varësisë.

6. Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian organizon takime periodike.

7. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Byroja e Kuvendit.

Neni 7

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian

(Ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar shkronja "a", zëvendësuar fjalë në shkronjën "e" me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian ka këto përgjegjësi:

a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian;

b) siguron diskutim të vazhdueshëm për politikën e integritetit europian, të zbatuara nga institucionet shtetërore me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;

c) monitoron zbatimin e detyrimeve gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, jep rekomandimet përkatëse për çështjet e shqyrtuara tek institucionet përgjegjëse dhe informon sipas rastit komisionin përgjegjës për çështjet europiane për gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit;

ç) organizon takime me grupet e interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile për çështje që lidhen me detyrimet për hapjen dhe mbylljen e kapitujve të negociatave;

d) zhvillon takime me ministrin përgjegjës për negociatat me Bashkimin Europian dhe me strukturën përgjegjëse për negociatat;

dh) këshillon dhe jep opinione në lidhje me ecurinë e procesit të negociatave;

e) mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin nëpërmjet bashkëkryetarëve të Këshillit Kombëtar për Integritet Europian;

ë) raporton një herë në vit në Kuvend për punën e Këshillit.

2. Gjatë veprimtarisë së tij Këshilli shqyrton dhe këshillon për çështje që vlerësohen të rëndësishme për procesin e integritetit evropian.

Neni 8

Sekretariati teknik

(Ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023)

1. Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian asistohet nga Sekretariati Teknik, i cili kryen funksione këshillimore dhe administrative dhe përbëhet nga punonjësit e administratës së Kuvendit.

2. Rregulla të detajuara për përbërjen, organizimin, funksionimin, numrin e punonjësve dhe përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik miratohen me vendim të Byrosë së Kuvendit.

3. Vendimi i Byrosë së Kuvendit për shtim të numrit të punonjësve në organikën e Kuvendit i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe ministrisë përgjegjëse për financat për sigurimin e mbështetjes së nevojshme buxhetore për këtë qëllim.

Neni 9

Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin

1. Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin (Komiteti) është strukturë e përbashkët e Kuvendit dhe Parlamentit Evropian që funksionon sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

2. Komiteti përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian dhe anëtarë të Kuvendit, të cilët propozohen sipas përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit për delegacionet e përhershme pranë organizmave ndërkombëtarë. Për aq sa është e mundur, anëtarët e këtij Komiteti duhet të jenë anëtarë të komisionit përgjegjës për çështjet evropiane.

3. Komiteti kryesohet me rotacion nga Parlamenti Evropian dhe Kuvendi i Shqipërisë.

4. Komiteti funksionon sipas rregullores së brendshme, të miratuar bashkërisht, dhe vendimarrja realizohet me konsensus.

5. Kuvendi, në seancën më të parë plenare, informohet pas çdo takimi për të gjitha çështjet e diskutuara dhe konkluzionet e takimit.

Neni 10

Komisioni përgjegjës për çështjet evropiane

(Ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Komisioni përgjegjës për çështjet evropiane është organ i përhershëm i Kuvendit, i cili mbulon çështjet e negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimit Evropian.

Kompetencat e komisionit përgjegjës për çështjet evropiane përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në këtë ligj.

KREU III

KOMPETENCAT DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Neni 11

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit në çështjet evropiane

(Ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023)

1. Kuvendi, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, në lidhje me çështjet evropiane:

a) siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European në ushtrimin e funksionit legjislativ;

b) monitoron dhe kontrollon punën e Këshillit të Ministrave, ministrit përgjegjës për negociatat me Bashkimin European, institucioneve të ngarkuara për zbatimin e detyrave në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European;

c) shqyrton raportet/konkluzionet e Bashkimit European dhe qëndrimet e Republikës së Shqipërisë, si dhe jep rekomandime mbi to;

ç) bashkëpunon me Parlamentin European dhe me parlamentet e vendeve anëtare të Bashkimit European;

d) monitoron punën e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj për çështjet e integritetit european dhe bashkëpunon me to;

dh) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për çështjet e integritetit european;

e) përfaqëson interesin publik në procesin e negociatave, në takime dhe në forumet e përbashkëta me institucionet europiane;

ë) informon publikun për pozicionin e institucioneve europiane dhe vendeve anëtare të Bashkimit European ndaj procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

2. Kuvendi në lidhje me çështjet europiane angazhohet edhe për:

a) vendosjen e dialogut të përshtatshëm politik ndërmjet palëve në proces;

b) monitorimin e zbatimit të kuadrit negociator, Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe asistencën financiare të Bashkimit European;

c) forcimin e bashkëpunimit rajonal për çështjet e integritetit european.

Neni 12

Ndërveprimi me institucionet e Bashkimit European

(Ndryshuar pika 1, shtuar pika 3 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Kuvendi merr pjesë në nisma rajonale dhe europiane të bashkëpunimit ndërparlamentar për çështje të negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

2. Kuvendi përfaqësohet në këto marrëdhënie nga anëtarë të tij, të cilët propozohen sipas përcaktimit në Rregulloren e Kuvendit për delegacionet e përhershme pranë organizmave ndërkombëtarë.

3. Kuvendi bashkëpunon me Parlamentin European dhe parlamentet e Shteteve Anëtare në kuadër të mbështetjes së procesit të negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

Neni 13

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me Këshillin e Ministrave

(Ndryshuar titulli, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Këshilli i Ministrave bashkëpunon dhe bashkëvepron me Kuvendin për çështje që lidhen me:

a) procesin e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European;

b) procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar shqiptar me legjislacionin e BE-së;

c) angazhimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit dhe komunikimin në kuadër të procesit të negociatave/anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European;

ç) projektmarrëveshjet dhe konventat që duhen miratuar me Bashkimin Europian në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

d) projektaktet që kanë të bëjnë me angazhimet në traktatet e Bashkimit Europian, me përjashtim të akteve administrative;

dh) projektaktet e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe që janë të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë;

e) projektaktet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të Bashkimit Europian.

Neni 14

Kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit përgjegjës për çështjet europiane

(Ndryshuar titulli, zëvendësuar fjalë në fjalinë hyrëse, shtuar shkronjat "f", "g", "gj", "b", "i", "j", "k", "l" me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023)

Komisioni përgjegjës për çështjet europiane, në përmbushje të funksioneve të tij, ushtron edhe këto përgjegjësi:

a) shqyrton, së bashku me komisionet e tjera parlamentare, projektligjet që kanë lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së;

b) monitoron Këshillin e Ministrave / ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritimit për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE;

c) nxit ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritimit europian, që të hartojë dhe të përditësojë planin kombëtar për integrimin europian, si dhe monitoron zbatimin e tij;

ç) monitoron kuadrin e përgjithshëm të bisedimeve për anëtarësim;

d) monitoron, së bashku me komisionet e tjera të përhershme, zbatimin e legjislacionit shqiptar të përafruar me legjislacionin e BE-së;

dh) bashkërendon punën me Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin për të mbajtur marrëdhënie të bashkëpunimit me strukturat e Parlamentit Europian, si dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së;

e) bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e integritimit europian;

ë) harton dhe shqyrton projektrezoluta lidhur me Planin Kombëtar për Integrimin Europian;

f) shqyrton pozicionet negociuese të paraqitura nga struktura negociatore dhe harton një raport të posaçëm me rekomandime lidhur me këto pozicione negociuese;

g) lehtëson debatin politik dhe gjetjen e konsensusit ndërpartiak për miratimin dhe ndryshimin e ligjeve, strategjive apo rezolutave të nevojshme për përshpejtimin e procesit të negociatave;

gj) kërkon raportime periodike çdo 3 muaj nga ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin Europian për ecurinë e procesit të negociatave;

h) në bashkërendim me Komisionin për Politikën e Jashtme organizon takime dhe diskutime me parlamentet kombëtare të shteteve anëtare dhe Parlamentin Europian;

i) thërret për mendim, sipas nevojës, ekspertë të fushave përkatëse dhe grupe interesi;

j) mbikëqyr zbatimin e kriterëve gjatë procesit të negociatave;

k) shqyrton të gjitha marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit Europian dhe/ose me vendet e Bashkimit Europian, si dhe marrëveshjet me karakter të mbështetjes financiare;

l) zhvillon mbledhje të përbashkëta me komisionet e tjera parlamentare për çdo projektakt që mbart ndikim në procesin e anëtarësimit.

Neni 14/1

Procedura për shqyrtimin e pozicioneve negociuese

(Shtuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European i paraqet komisionit përgjegjës për çështjet europiane pozicionin negociues.

2. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane e përfshin menjëherë pozicionin negociues dhe shtesat/ndryshimet e tij në kalendarin e punimeve të komisionit dhe e shqyrton jo më vonë se 7 ditë nga data e përfshirjes së pozicionit negociues në kalendarin e punimeve të tij.

3. Në rast se pozicioni negociues dhe shtesat/ndryshimet e tij nuk janë përfshirë në kalendarin e punimeve të komisionit brenda 3 ditëve nga data e paraqitjes të tij, ai automatikisht konsiderohet i përfshirë në kalendar dhe shqyrtohet jo më vonë se 7 ditë nga data e përfshirjes në kalendar.

4. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane në përfundim të shqyrtimit të pozicionit negociues miraton një raport të posaçëm me rekomandime për pozicionin negociues, i cili duhet të merret parasysh nga struktura negociatore.

5. Në rast se rekomandimet e Komisionit sipas pikës 4 të këtij neni nuk merren parasysh, ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European informon me shkrim Komisionin për arsytet e mosmarrjes parasysh të rekomandimeve.

6. Struktura negociatore vijon me hartimin përfundimtar të pozicionit negociues nëse komisioni përgjegjës për çështjet europiane nuk dërgon raportin e posaçëm me rekomandimet jo më vonë se 14 ditë nga data e paraqitjes pranë Komisionit.

7. Anëtarët e komisionit përgjegjës për çështjet europiane hartojnë dhe nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit për marrjen në shqyrtim të pozicioneve negociuese.

KREU IV PJESËMARRJA NË PROCESIN E PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT

Neni 15

Plani Kombëtar për Integrimin European

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Këshilli i Ministrave depoziton në Kuvend Planin Kombëtar për Integrimin European.

2. Kuvendi, çdo vit, zhvillon një seancë me debat për detyrat që dalin për Kuvendin, të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin European dhe miraton rezolutën përkatëse.

3. Kuvendi harton kalendarin e projektligjeve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit European në përputhje me planin e përafrimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 16

Lista e projekteve për përafrim legjislacioni

(Ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023)

1. Këshilli i Ministrave, brenda muajit janar të çdo viti, i dërgon Kuvendit, listën e përditësuar të projektligjeve, me qëllim programimin e punës së Kuvendit dhe përcaktimin e procedurave të shqyrtimit, sipas rastit.

2. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane shqyrton listën e projekteve që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European dhe, në bashkëpunim me komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, përgatit një raport të posaçëm me

rekomandime, të cilat i paraqiten Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Projektligjet e përafrimit të legjislacionit

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; shtuar fjalë në fund të pikës 1, ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Projektligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European, të paraqitura për miratim në Kuvend, shqyrtohen paraprakisht nga komisioni përgjegjës për çështjet europiane dhe më pas nga komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit, sipas fushës së përgjegjësisë dhe rregullave procedurale të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

2. Projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për instrumentet e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European.

3. Organet e Kuvendit, kur konstatojnë mangësi në këtë dokumentacion, i kthejnë Këshillit të Ministrave projektligjin, i cili brenda 15 ditëve duhet të ridërgohet në Kuvend i plotësuar.

4. Institucionet propozuese të projektligjit krijojnë bazën e të dhënave të tabelave të përputhshmërisë së ligjeve të miratuara, të përditësuara.

5. Institucioni propozues i projektligjit duhet të reflektojë në tabelën e përputhshmërisë të gjitha ndryshimet që ka pësuar projektligji, brenda 15 ditëve nga data e publikimit të ligjit të miratuar.

Neni 17/1

Procedura e shqyrtimit të ligjeve që synojnë përafrimin

(Shtuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfshin menjëherë në programin dhe kalendarin e tij të punimeve dhe shqyrton me procedurë të përshpejtuar ligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit, me përjashtim të ligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës.

KREU V

RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 18

Raportimi në Kuvend

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; shtuar fjalë në pikën 2 dhe 3 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Këshilli i Ministrave, deri më 31 janar të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport të detajuar mbi zbatimin e detyrimeve, sipas Planit Kombëtar për Integrimin European, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi European dhe donatorë të tjerë, për vitin paraardhës. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës Kuvendi miraton rezolutën përkatëse.

2. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se tre javë nga publikimi i Raportit të Progresit për procesin e negociatave të Komisionit European, raporton në Kuvend për gjetjet, rekomandimet, situatën aktuale të zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale të vendit, si dhe për angazhimet konkrete për përmbushjen e rekomandimeve. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës Kuvendi miraton rezolutën përkatëse.

3. Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European informojnë në seancë plenare konkluzionet mbi negocimin e një kapitulli ose grup kapitujsh pas zhvillimit të konferencës ndërqeveritare me Bashkimin European për anëtarësim.

Neni 19

Raportimi në komisionin përgjegjës për çështjet europiane

(Ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023; ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European dhe/ose Kryenegociatori paraqesin në fund të çdo 4-mujori në komisionin përgjegjës për çështjet europiane një raport përmbledhës për:

- a) progresin mbi procesin e përafrimit me *acquis* të BE-së;
- b) ecurinë e procesit të negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimin European;
- c) ecurinë e ndjekjes së rekomandimeve (të pranuar) të komisionit përgjegjës për çështjet europiane lidhur me pozicionet negociuese.

2. Me kërkesë të komisionit përgjegjës për çështjet europiane ose të 1/3 së anëtarëve të tij, ministri përgjegjës për negociatat dhe/ose Kryenegociatori me Bashkimin European thirret për të informuar për çdo çështje që ka të bëjë me negociatat e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

Neni 20

Raportimi i institucioneve të pavarura

(Ndryshuar me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

Komisioni përgjegjës për çështjet europiane dhe komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të thërrasin institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione në çdo kohë për zbatimin e detyrimeve të procesit të negociatave dhe anëtarësimit dhe zbatimin e kuadrit ligjor përkatës.

Neni 21

Mbikëqyrja e zbatueshmërisë së kuadrit normativ për përafrimin e legjislacionit

1. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane koordinon me komisionet e përhershme të Kuvendit procesin e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së kuadrit normativ, që synon përafrimin e legjislacionit, sipas fushave kryesore të integritetit europian.

2. Komisionet e përhershme të Kuvendit, në fund të çdo sesioni parlamentar, u kërkojnë ministrive të linjës të përgatisin një raport lidhur me shkallën e zbatueshmërisë së kuadrit normativ që synon përafrimin e legjislacionit.

3. Raporti, me vlerësimet e komisionit përgjegjës, i dërgohet komisionit përgjegjës për çështjet europiane për të përgatitur analizë vlerësuese.

KREU VI

BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Neni 22

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

1. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane dhe komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas

fushës së përgjegjësise, ftojnë grupet e interesit për të marrë pjesë në seanca dëgjimore që lidhen me procesin e integritimit, si dhe në procesin e miratimit të kuadrit ligjor që synon përafrimin e legjislacionit.

2. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane mund të organizojë takime të hapura me shoqërinë civile për diskutimin e projektit të Planit të Veprimit të Kuvendit, për zbatimin e masave konkrete, lidhur me përparësitë për integrimin në Bashkimin European.

3. Procedurat e detajuara për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 23

Transparenca dhe informimi i publikut

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 77/2025, datë 4.12.2025)

1. Kuvendi përcakton rregullat e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për angazhimin dhe informimin e tyre lidhur me angazhimet në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European duke garantuar transparencën e veprimtarisë së tij për çështjet e negociatave dhe anëtarësimit dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në këtë proces.

2. Kuvendi, në faqen zyrtare të internetit, krijon një rubrikë të veçantë për informimin e publikut për çështjet e integritimit europian.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Shfuqizim

Ligji nr. 9252, datë 8.7.2004, “Për punën e Kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin European”, shfuqizohet.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në vitin 5.3.2015

Shpallur me dekretin nr. 8998, datë 17.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani